

SHOQËRIA CIVILE PUBLIKON RAPORTIN MONITORUES PËR KOMUNËN E LIPJANIT

“YAHR”: Nga 117 premtime, Komuna realizoi vetëm tri

Arian Duriqi

LIPJAN, 17 TETOR – Në qoftë se kryetari i Lipjanit, Imri Ahmeti, ecën me trendin aktual të përmbushjes së premtimeve, atëherë ai për 4 vjet mandat nuk do të mund të përmbushë as 10-përqindëshin e premtimeve që ka dhënë në fushatën elektorale. Kjo për faktin se raporti monitorues që ka publikuar shoqëria civile flet për vetëm 3 premtime të përmbushura plotësisht këtë vit nga 117 sa ka dhënë kryetari Ahmeti për katër vjet mandat. Në të vërtetë, Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv i OJQ “YAHR”, teksa ka publikuar raportin monitorues për Lipjanin deri në tetorin e këtij viti shkruan për rezultate jo të mira në përmbushje premtimesh. Sipas Krasniqit, janë mbi 90 për qind e premtimeve që në vitin e parë të mandatit 4-vjeçar janë pa asnjë përpjekje për realizim.

“Nga 117 premtime të dhëna kemi 93 premtime ose 79.48 për qind pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit. Në 5 premtime ose 4.27 për qind prej tyre ka shenja pozitive në realizimin e premtimit, në 4 premtime ose 3.41 për qind ka filluar procesi në rrugë të mirë. Janë 12 premtime ose 10.25 për qind prej tyre ku ka hapa konkretë në realizim dhe në fund janë 3 premtime ose 2.56 për qind të realizuara plotësisht”, ka thënë Krasniqi, bazuar në raportin e

fundit. Por njëherësh kjo OJQ ka tërhequr vërejtjen se duhet të merret parasysh se premtimet e dhëna janë për periudhën katërvjeçare të mandatit dhe se ka mbetur edhe një e treta e kohës për plotësimin e premtimeve. Pos premtimeve Krasniqi ka folur edhe për disa probleme të tjera. Ka thënë se qytetarët e Lipjanit kanë probleme serioze në fushën e zhvillimit urban. “Në Lipjan ka ende disa zona për të cilat nuk është bërë planifikimi hapësinor-urban. Probleme janë evidencuar edhe në zonat ku planet rregulluese janë miratuar, pasi ka probleme si rezultat i mosplanifikimit të mirë dhe mosmarrjes parasysh të kushteve në terren dhe nevojave të zonës së qytetit”, ka thënë ai. Por raporti ka edhe anët e veta pozitive. Për shembull, një performancë të mirë Krasniqi ka thënë se e ka pasur Drejtoria e Buxhetit dhe e Financave. Është përmendur një punë e mirë në shpenzim buxheti dhe në arkëtim të të hyrash.

“Kemi një performancë të mirë në shpenzim të buxhetit dhe në arkëtimin e të hyrave të Komunës, me gjithë faktin se është hequr taksa komunale për biznese. Për periudhën janar-shtator 2014 është arritur që nga planifikimi i të hyrave për vitin 2014 prej 1.166.927 eurosh ato të realizohen në shkallën prej 98.36 për qind ose në vlerën prej 1.147.765 eurosh”, ka thënë ai. Ndërkohë që nga OJQ “YAHR” janë



Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv i OJQ “YAHR”, teksa ka publikuar raportin monitorues për Lipjanin deri në tetorin e këtij viti, shkruan për rezultate jo të mira në përmbushje premtimesh. Sipas Krasniqit, janë mbi 90 për qind e premtimeve që në vitin e parë të mandatit 4-vjeçar janë pa asnjë përpjekje për realizim

dhënë edhe rekomandimet. Dhe janë plot 12 sosh. “Kërkohet angazhim më i madh i kryetarit të Komunës në përmbushjen e premtimeve elektorale, kërkohet menaxhim më i mirë dhe transparencë më e madhe në shpenzimin e fondeve publike, afrim i qasjes në informacione dhe dokumentacion për të gjitha palët e interesuara, komunikim më kualitativ me shoqërinë civile dhe media, organizim më i sh-

peshtë i takimeve publike me qytetarë veçanërisht në fazën e përpilimit të projekteve kapitale dhe buxhetit komunal”, këto ishin ndër rekomandimet e para nga 12 sa është numri në total.

Ndërkohë që të premten nuk ka pasur një deklaratë zyrtare nga Komuna e Lipjanit lidhur me raportin monitorues që është publikuar nga OJQ “YAHR”.

© KOHA Ditore

FERIZAJ, 17 TETOR – Organizata “Caritas Kosova” ka publikuar raportin monitorues për bashkimin e komunave të reja në ditë. Lokali është caktuar tani. Themelore, në pronë e kompanisë Hapësirat e lokales bukës për një kompania “Bioshushqimin do të përcjellëse lidhur energjisë dhe në t’i heqë Komuna identifikimi i të përfitojnë këtë nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale shumë familje llogaritë që dikur që të jenë në të tarëve të varfërisht për të zvogëluar tepërt në çerç “Lagjen e re”, “Caritas Kosova nohen fuqi tjetër shërbimet të kryesueshëm është i punësuar një numër i punës dhe të vendosur të hapet”, është Svarqa. Ndërkohë drejtuesit e organizatës “Caritas Kosova” kërkohet dhe mendojmë fëritë ta hapim themelore ku falas në një shujtë ditore pritet të zgjas 4 vjet të qartësohen kë